


Fillimi > -Kronikë

# Qëlluan me armë në ajër, arrëstohen 7 persona në Dibër, çfarë zbuloi Policia në pyll

08 Prill, 2020 12:51 |



Madhësia e tekstit:  

## DIBËR

Shtatë persona janë arrestuar në Dibër pasi qëlluan me armë kallashnikov në ajër. Këta persona kanë qëlluar gjatë mbrëmjes së djeshme rreth orës 23:50 në ajër dhe fshehën armët në pyll. Nga zhvillimi i operacionit "Soponika" Policia zbuloi dhe sekuestroi 1 kallashnikov, 4 armë gjahu çifte, si dhe 6 motorsharra të vjedhura. Po personat e arrestuar janë autorë të një sërë vjedhjesh.

PAGESA DHE TRANSFERTA PËR BIZNESIN TËND?

## NJOFTIMI NGA POLICIA

Finalizohet me sukses operacioni policor "Soponika".

Qëlluan me armë zjarri në ajër, identifikohen dhe kapen në kohe reale autorët.

Gjatë operacionit gjendet i fshehur në pyll edhe kallashnikovi me të cilin qëlluan në ajër.

Shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër arrestojnë në flagrancë 7 persona dhe procedojnë penalisht 1 tjetër.

Të arrestuarit dyshohen se janë autorë të një sërë vjedhjesh.

Sekuestrohen në cilësinë e provës materiale, 1 kallashnikov, 4 armë gjahu çifte, si dhe 6 motorsharra të vjedhura.

Shërbimet e DVP Dibër, krahas angazhimit maksimal për monitorimin e zbatimit të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19, vijojnë punën edhe për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë.

Shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, në bazë të informacioneve të siguruara në rrugë operative, se një grup personash po gjuanin me armë zjarri në pyll, organizuan punën dhe falë veprimeve hetimore të kryera finalizuan me sukses operacionin policor të koduar "Soponika" në kuadër të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

- K. C., 23 vjeç, banues në Arras;
- S. Xh., 18 vjeç, banues në Arras;
- A. Gj., 21 vjeç, banues në Kastriot;
- Xh. B., 28 vjeç, banues në Laçes;
- D. B., 21 vjeç, banues në Laçes;
- G. D., 24 vjeç, banues në Kastriot;
- T. Xh., 42 vjeç, banues në Fushë Çidhen;

Si dhe u procedua penalisht në gjendje të lirë shtetasi S. B., 29 vjeç, banues në Fushë Çidhen.

Këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, rreth orës 23:50, kanë qëlluar me armë zjarri në ajër dhe më pas e kanë fshehur armën në pyll.

Gjatë operacionit janë sekuestruar nga Policia, në cilësinë e provës materiale, 1 armë zjarri kallashnikov, 4 armë gjahu çifte, 2 prej të cilave janë të vjedhura, si dhe 6 motorsharra.

Nga veprimet hetimore rezulton se këta shtetas janë autorë të disa vjedhjeve në banesa.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, për veprat penale "Vjedhja e kryer në bashkëpunim", "Prishja e qetësisë publike", "Mbajtja pa leje e armëve shpërthyeshe dhe municionit", "Mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", "Pastrimi i produkteve të veprës penale", "Detyrim për të kallëzuar provën", "Moskallëzim krimi" dhe "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës".

## (BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)


**Etiketa:** arme   dibër   kallashnikov   motorsharra   policia   vjedhje

## TË NGJASHME



"Maska, doreza dhe dezinfektantë", Komitetet fetare, ndihmë dhe mbështetje për Policinë

09 Prill, 2020



Komitetet fetare solidarizohen, Kisha Ortodokse Autoqefale i dhuron policisë së Tiranës maska, doreza e dezinfektantë

09 Prill, 2020


Shfaq Komentet (0)

## TË FUNDIT NGA -KRONIKË



FOTO-EMRI/ Hitej si punonjës policie dhe përfitonte para përmes mashtimit, arrestohet 43-vjeçari në Kuçovë

Eneida Petova | 09 Prill, 2020



"Ditët më të vështira po i hedhim pas shpine", Tritan Kalo tregon ç'ndodh tek Infektiv: Duhet të vijnë masat shtrënguese

09 Prill, 2020



Shkon në 23 numri i viktimave nga COVID-19, ndërron jetë e moshuara tek Infektiv

09 Prill, 2020




Në luftë me zjarrin në Elbasan, zjarrfikësi pickohet gjatë detyrës nga gjarpëri, me urgjencë në spital

09 Prill, 2020



"Virus i mallkuar"! Mesazhi përletës i fëmijëve të mësuesit shqiptar që vdiq në SHBA, ja si e kujton shkolla ku punoi

09 Prill, 2020



U kallëzua nga PD, SPAK nis hetimin për tenderin e ushqimeve të Ministrisë së Mbrojtjes: U regjistrua çështja penale


09 Prill, 2020

## KATEGORIA VIDEO



Video/ Djali i Schwarzenegger tregon muskujt dhe është identik si i ati

09 Prill, 2020



Karantina hot e Bella Thorne: Sot dielli shkëlqen dhe e bën të lumtur zemrën time

09 Prill, 2020



Video/ Mjeku italian vë si maskë mbrojtëse një pelenë bebesh, ia sygjeron të gjithëve

09 Prill, 2020



Jeta në çadër në kohën e koronavirusit, familja me 6 anëtarë apelon për ndihmë: Duam një shtëpi të re

09 Prill, 2020



"Në bordin e tragetit ka të infektuar me koronavirus", pasagjerët i kap paniku, hidhen në ujë në Indonezi

09 Prill, 2020



Shniciel me fileto pule, patate furre dhe sallate fshati

09 Prill, 2020